



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

**Nr. 138, Datë 15 / 12 / 2017**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 22, datë 17.02.2016, të bërë nga E.M, kundër Qendrës Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*etnisë*<sup>1</sup>” dhe “*gjendjes familjare*”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I:**

E.M në ankesën e saj deklaron se: “Në datë 29.01.2016 është njoftuar nga sekretaria e drejtorisë së spitalit për të firmosur për njoftimin e largimit nga puna. Ankuesja ka refuzuar të firmosë duke argumentuar se pse po largonin një nënë kryefamiljare me tri fëmijë me 22 vite punë si sanitare pa asnjë vërejtje dhe pa të ardhura të tjera. E.M pretendon se për shkak të etnisë dhe gjendjes familjare ajo po largohet nga puna dhe do qëndrojnë në punë dy sanitare të tjera me më pak vite pune dhe me familje të rregullta”.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

<sup>1</sup>E.M i përket komunitetit egjiptian të qytetit të Elbasanit

Diskriminimi për shkak të etnisë dhe gjendjes familjare janë shkaqe të mbrojtura nga ligji 10221/2010 dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga ankuesja, E.M, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për mbrojtjen nga diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

- Me shkresën nr. 237/1, datë 18.02.2016 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga E.M.

Me shkresën nr. 357/1, datë 01.03.2016, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan, informon Komisionerin se: *“Struktura Analitike e Shërbimit Spitalor Elbasan për vitin 2015 ka patur 117 sanitare ndërsa për vitin 2016 ka 65 sanitare. Kriteret për largim të 52 sanitareve janë përcaktuar nga shkresa nr.244, datë 15.01.2016 e Ministrit të Shëndetësisë të pasqyruar në Urdhrit nr.85, datë 20.01.2016 të nxjerrë nga Drejtoria e Spitalit Elbasan, për shqyrtimin e dosjeve të personelit. Komisioni i ngritur për çdo shërbim, me vendim nr.3, datë 20.01.2016, pasi shqyrtoi dosjet dhe performancat, përcaktoi personat që do të largoheshin. Me datë 29.01.2016 u thirrën nga Komisioni të gjithë punonjësit që do të largoheshin për ti komunikuar “Përfundimin e marrëdhënieve të punës”, ndër to edhe E.M, iu paraqit shkresa nr. 158, datë 29.01.2016, të cilën nuk pranoi ta firmosë. Për këtë fakt është mbajtur procesverbal nga ana e Komisionit dhe njoftimi, E.M i është dërguar me postë”.*

- Me shkresën nr. 237/3, datë 07.03.2016 nga ana e Komisionerit i është kërkuar subjektit, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasanin informacion shtesë në lidhje me ankesën.

Me datë 08.04.2016, në zbatim të Urdhrit të Inspektimit nr.56, datë 01.04.2016 u realizua inspektimi pranë subjektit, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan. Nga ana e spitalit ishin të pranishëm, D.T, me detyrë Drejtorë e Spitalit dhe B.D, me detyrë Specialiste e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun. B.D informoi se shkak i vetëm i largimit nga puna të

E.M është bërë ndryshimi i strukturës analitike të Shërbimit Spitalor Elbasan, si pasojë e të cilit janë larguar nga puna 52 sanitare, nga të cilat vetëm 2 të komunitetit rom e egjiptian. Aktualisht janë në punë 65 sanitare, nga të cilat 4 prej tyre të komunitetit rom e egjiptian, pra raca nuk ka qenë kriter për largimin e tyre nga puna. B.D shpjegoi se të gjitha punonjëset sanitare janë në kushte jo të mira familjare dhe sociale dhe se në zyrën e burimeve njerëzore nuk disponojnë informacion mbi gjendjen familjare dhe sociale të punonjësve”.

- Me shkresën nr. 237/4 datë 27.05.2016 u njoftuan subjektet për realizimin e një seance dëgjimore mes palëve për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e tyre.

Më datë 02.06.2016 në mjediset e zyrës së Komisionerit u zhvillua seanca dëgjimore. Në këtë seancë morën pjesë: B.D me detyrë specialiste e Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe subjekti ankues, E.M.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore E.M i qëndroi pretendimeve të saja të bëra prezent në formularin e ankesës si dhe informoi se janë rikthyer në punë punonjëset: E.P, F.D dhe N.F të cilat ishin larguar më parë nga puna në spital.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore B.D deklaroi se: *“E gjithë procedura e ndjekur për ndërprerjen e marrëdhënieve të punës për shkak të strukturës së re është kryer në përputhje të plotë më zbatimin e Udhëzimit të Ministrisë të Shëndetësisë dhe si rrjedhojë nuk ka ardhur si pasojë e diskriminimit siç pretendon ankuesja. Vetëm F.D është kthyer në punë por jo në pozicionin e sanitarës por në pozicionin si lulishtare. Disiplina në punë për punonjësit është vlerësuar nga kryeinfermieret e spitalit”.*

- Me shkresën nr. 638, datë 14.06.2016 nga ana e Komisionerit i është kërkuar subjektit, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasanin formacion shtesë në lidhje me pretendimin e subjektit ankues gjatë seancës dëgjimore.

Me shkresën nr. 1041/1, datë 30.06.2016, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan, informon Komisionerin se: *“Aktualisht numri i punonjëseve sanitare të spitalit është i njëjtë me atë të strukturës së datës 18.01.2016, pra 65 sanitare. Nga lista e emrave që ka parashtruar ankuesja në seancë dëgjimore, vetëm dy nga punonjëset janë rimarrë në punë, F.D në pozicionin e lulishtares dhe P.Sh në pozicionin e punonjëses hoteliere”.*

Duke qenë se Ministria e Shëndetësisë është institucioni që ka udhëzuar Qendra Spitalore “XhaferKongoli”, Elbasan, për zbatimin e strukturës së re, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me shkresën nr.241/3, datë 08.07.2016 ka kërkuar informacion lidhur me faktin nëse kriteri i arsimit ka qenë i detyruar të merrej në vlerësim dhe për punonjësit sanitarë dhe nëse po, arsyetimin që ka përfshirë këtë kriter.

Lidhur me këtë fakt, me Vendimin nr.119, datë 15.07.2016, Komisioneri vendosi pezullimin e procedimit administrativ<sup>2</sup> për ankesën e E.M, me qëllim marrjen e informacionit të nevojshëm, për një gjykim sa më të drejtë, objektiv dhe të paanshëm të rastit në fjalë.

- Me shkresën me nr.612/2, datë 06.07.2017 Komisioneri ka kërkuar informacion shtesë nga Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan lidhur me tabelën e pikaverazhit për të gjitha punonjëset sanitare të spitalit, si dhe kopje të vendimeve të largimit nga puna për të gjitha punonjëset sanitare që propozoheshin për t’u larguar nga puna në zbatim të shkresës nr.261, datë 18.01.2016 të Ministrit të Shëndetësisë.

Me shkresën nr.1296/1, datë 11.07.2017, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan, nuk ka dhënë informacionin e kërkuar nga Komisioneri.

- Me shkresën me nr.612/4, datë 20.07.2017 Komisioneri ka kërkuar përsëri nga Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan, saktësim informacioni dhe plotësim dokumentacioni lidhur me çështjen në fjalë.

Me shkresën nr.1382/1, datë 31.08.2017 Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan, nuk ka dhënë informacion të plotë të kërkuar nga Komisioneri, por ka informuar se, në lidhje me dokumentacionin e kërkuar, duke qenë se në institucionin e spitalit po ushtrohet një kontroll, nuk ka mundësi që nga arshiva të nxjerrin dokumentacionin e kërkuar, dhe për këtë kërkohet rreth 40 ditë afat.

- Me shkresën me nr.857/1, datë 07.09.2017 Komisioneri ka njoftuar subjektin ankues në lidhje me informacionin e dërguar nga Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan.

Me datë 07.11.2017, në zbatim të Urdhrit të Inspektimit nr.156, datë 01.11.2017 u realizua inspektimi pranë subjektit, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan. Nga ana e spitalit ishte e pranishme, B.D, me detyrë Specialiste e Burimeve Njerëzore. B.D vuri në dispozicion të inspektorëve informacionin e kërkuar me shkresën nr.612/4, datë 20.07.2017.

### **Pas vlerësimit të fakteve dhe provave të grumbulluara dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlerëson:**

E.M me datë 12.05.1994 ka filluar punë si sanitare pranë subjektit Qendra Spitalore “Xh.Kongoli”, Elbasan e vërtetuar me Librezën e punës së shtetases E.P me Nr. regjistri themeltar 4232. Me shkresën nr. 158, datë 29.01.2016, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli” ka njoftuar E.M mbi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës me datë 30.04.2016.

Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga palët, rezulton se:

---

<sup>2</sup>Në zbatim të nenit 85/3 të Kodit të Procedurave Administrative të ndryshuar.

- Me daljen e Udhëzimit nr.13, datë 15.01.2016 të Ministrit të Shëndetësisë<sup>3</sup>, ka filluar procesi i ristrukturimit të shërbimit spitalor në spitalet rajonale të vendit, duke përcaktuar dhe ngritjen e komisioneve për shqyrtimin e dosjeve të punonjësve të cilëve u suprimohet pozicioni i punës. Kriteret bazë, mbi të cilat komisioni i shqyrtimit të dosjeve të punonjësve do të bëjë vlerësimin në zbatim të strukturës së re të shërbimit spitalor rajonal, për pozicione të njëjta të cilat suprimohen, do të jenë: Arsimimi, Performanca në punë e punonjësve dhe Disiplina në punë.

Në zbatim të këtij Udhëzimi, me shkresën nr.261/1, datë 18.01.2016, Ministria e Shëndetësisë ka miratuar Strukturën Analitike të Qendrës Spitalore “Xhafer Kongoli”. Në këtë kuadër, në strukturën e re, në Sektorin e Shërbimeve Mjedisore, është përcaktuar një numër prej 65 sanitarësh në total (për administratën dhe shërbimet spitalore), duke mos bërë përcaktimin dhe ndarjen nëpër pavione specifike. Shpërndarja e sanitareve nëpër pavione do të realizohet përmes një plani pune të përmuajshëm, sipas nevojave të organizimit të punës pranë kësaj qendre spitalore, dhe jo me emërim të përhershëm (apo të përkohshëm) të sanitareve pranë një pavioni të veçantë. Në strukturën e re të Qendrës Spitalore Elbasan ishin parashikuar ndryshimi i numrit të punonjësve në disa pozicione pune si: sanitar, infermier, psikolog, punonjës socialë, receptionist dhe kimist.

Referuar Strukturës Analitike të Drejtorisë së Spitalit Elbasan<sup>4</sup> të vitit 2013, numri i sanitareve në total ishte 112, të specifikuar sipas pavioneve të veçanta, rast pas rasti ndërsa në strukturën e re duhet të qëndronin në punë 65 sanitare.

Në zbatim të Urdhrit nr.85, datë 20.01.2016 të Drejtores së Qendrës Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan, për zbatimin e shkresës me nr. 261, datë 18.01.2016 të Ministrit të Shëndetësisë, është urdhëruar ngritja e Komisioneve me përbërje: Shef Shërbimi, K/Infermiere Përgjithshme, Përgjegjëse e Burimeve Njerëzore dhe Specialiste e Burimeve Njerëzore, për shqyrtimin e dosjeve të punonjësve të cilëve u suprimohet pozicioni i punës. Këto Komisione kanë shqyrtuar dosjet e personelit për çdo shërbim, dhe në bazë të kriterëve të përcaktuara për vlerësimin e tyre ka bërë dhe vlerësimet rast pas rasti, sipas Tabelës së Pikaverazhit, sipas të cilit është vlerësuar se:

- Arsimi i mesëm vlerësohet - 10 pikë dhe ai 8-vjeçar - 5 pikë.
- Performanca: Shumë mirë - 10 pikë. Mirë - 7 pikë. Mjaftueshëm - 5 pikë. Dobët - 2 pikë.
- Disiplina: Shumë mirë – 10 pikë. Mirë – 7 pikë. Dobët – 2 pikë.

Me shkresën nr.85/1, datë 20.01.2016, drejtorja e Qendrës Spitalore “Xhafer Kongoli” pas kërkesës së shefave të pavioneve, ka urdhëruar që, sanitarët në Laboratorët Klinikë Biokimikë dhe Anatomopatologjisë, Banka e Gjakut, Imazherisë dhe Sallës së Operacionit të mos i

<sup>3</sup>Referuar shkresës me nr.244 prot., datë 15.01.2016, të Ministrit të Shëndetësisë.

<sup>4</sup>Referuar shkresës me nr.3525/1 prot., datë 30.07.2013, të Ministrit të Shëndetësisë.

nënshtroreshin konkurrimit për shkak të specifikave të pastrimit të aparaturave në këto shërbime dhe përvojës që kishin këto sanitare.

Referuar vlerësimin të bërë nga Komisioni i Shërbimit të Sëmundjeve të Brendshme, rezulton se punonjësja E.M është vlerësuar në total me 22 pikë (Arsimi 5 pikë, Performanca 7 pikë dhe Disiplina 10 pikë).

Me shkresën nr.1041/1, datë 30.06.2016, Qendra Spitalore Elbasan ka sqaruar se performanca e çdo punonjësi është përcaktuar në bazë të vlerësimin vjetor, ndërsa vlerësimi për kriterin e disiplinës është bërë në bazë të pikaverazhit të përcaktuar nga Shefat e Shërbimeve dhe K/infermiera përkatëse, sipas shënimeve të mbajtura gjatë vitit 2015, shënime të cilat janë asgjësuar në Mars të vitit 2016.

Bazuar në Strukturën e re Analitike të Spitalit Rajonal Elbasan, rezulton se nga 25 sanitaret që ishin të punësuar pranë Pavionit të Pathologjisë, ku ishte e punësuar dhe ankuesja, 14 prej tyre janë larguar dhe kanë ngelur 11 sanitare.

Nga informacionet e analizuar për punonjëset sanitare në repartin e Patologjisë, rezulton se nga 25 punonjëse gjithsej, 2 punonjëse i përkasin komunitetit egjiptian<sup>5</sup> dhe nga 11 punonjëse të larguara, këto 2 punonjëse kanë rezultuar me më pak pikë dhe janë larguar si rezultat i kriterëve të vendosura nga Drejtoria e Qendrës Spitalore Elbasan. Nga analiza e Tabelës së Pikaverazhit të Shërbimit të Pathologjisë, rezulton se dy punonjëset që i përkisnin komunitetit egjiptian kishin vlerësimin minimal, me 5 pikë në kriterin e arsimit për shkak se ishin me arsim 8-vjecar.

Gjendja e vështirë e komunitetit rom dhe egjiptian njihet dhe nga qeveria e Republikës së Shqipërisë e cila me VKM nr.1072, datë 23.12.2015 ka miratuar “Planin Kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020” në të cilën shkruhet se: *“Romët dhe egjiptianët përfundojnë mesatarisht 5-6 vjet arsim, krahasuar me mesataren kombëtare që është 10 vjet<sup>6</sup>”*.

Për sa më sipër, sa i takon Urdhrit nr.85, datë 20.01.2016 të Drejtores së Qendrës Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan, lidhur me vendosjen e kriterit të arsimit për kategorinë e punonjësve “Sanitarë”, Komisioneri vlerëson se: vendosja e këtij kriteri ka qenë vendimtare dhe penalizuese njëkohësisht, për punonjëset që i përkasin komunitetit egjiptian të larguara si pasojë e ristrukturimit të spitalit. Mirëpo nisur nga natyra e punës së pozicionit sanitare, Komisioneri vlerëson se ky kriter është jo proporcional dhe jo i arsyeshëm, sa i takon detyrave funksionale të kësaj kategorie punonjësish. Ai i ka vënë në pozita jo të barabarta dhe diskriminuese, në raport me punonjëset e tjera që janë me arsim të mesëm dhe për më tepër kur arsimi nuk ka lidhje të drejtpërdrejtë me punën që ato kryejnë. Theksojmë se punonjësja E.M ka pasur një eksperiencë

<sup>5</sup>Referuar deklarimeve të punonjësve E.P dhe M.H.

<sup>6</sup>Statistika për komunitetin rom dhe egjiptianët i referohen: “Planit kombëtar të veprimit për integrimin e romëve dhe egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë, 2016-2020” miratuar me VKM nr.1072, datë 23.12.2015, faqe 3.

punë prej më shumë se 22 vitesh. Pra, për të gjithë këtë periudhë kohore niveli i arsimit të saj nuk ka qenë faktor pengues për realizimin e detyrave të saj si punonjëse sanitare.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ndalon diskriminimin e personave në lidhje me të drejtën e tyre për punësim. Kështu në nenin 12, pika 1, përcaktohet se ndalohet diskriminimi për shkak të racës dhe gjendjes familjare dhe që ka lidhje me: c) *“trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”*.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3 citon: *“Diskriminim i tërthortë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një dispozitë, kriter apo praktikë, e paanshme në dukje, do ta vinte një person ose grup personash në kushte jo të favorshme, në lidhje me shkaqet e parashtruara në nenin 1 të këtij ligji, në raport me një tjetër person ose grup personash, si dhe kur ajo masë, kriter a praktikë, nuk justifikohet objektivisht nga një synim i ligjshëm, ose kur mjetet e arritjes së këtij synimi, ose nuk janë të përshtatshme, ose nuk janë të domosdoshme dhe në përpjesëtim të drejtë me gjendjen që e ka shkaktuar atë”*.

Në përfundim, për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se praktika e ndjekur nga ana e Drejtorisë së Qendrës Spitalore “Xhafer Kongoli”, Elbasan, lidhur me vendosjen e kriterit të arsimit për kategorinë e punonjësve “Sanitarë”, duke i trajtuar të gjithë punonjësit sanitarë njëjloj pa marrë parasysh kushtet e ndryshme sociale që mund të kishin, përbën diskriminim substantiv (trajtim i barabartë i çështjeve të pabarabarta) për shkak të racës<sup>7</sup>, në fushën e punësimit.

Në lidhje me pretendimin e E.M se është larguar nga puna për shkak të gjendjes familjare, Komisioneri vlerëson se në Udhëzimin nr.13, datë 15.01.2016 të Ministrit të Shëndetësisë dhe Urdhrit nr.85, datë 20.01.2016 të Drejtores së Spitalit Rajonal Elbasan, nuk është bërë asnjë përcaktim për vlerësimin e punonjësve sipas gjendjes familjare të tyre dhe si rrjedhim dhe nga ana e komisionit të shqyrtimit të dosjeve të punonjësve nuk është bërë asnjë vlerësim mbi gjendjes familjare të punonjësve.

## PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 12 pika 1/c, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, germa a) dhe c), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7, 10 dhe 11 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

<sup>7</sup>Referuar Komisionit Evropian kundër racizmit dhe jo tolerancës. ECRI Rekomandimi Nr. 7, CRI(2003)8 “Diskriminim racial është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preference që bazohet se shkaqe si raca, ngjyra, gjuha, besimi fetar, shtetësia ose origjina etnike ose kombëtare, që justifikon përbuzjen për një person ose një grup personash, ose nocionin e superioritetit të një personi ose një grupi personash”.

## V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të tërthortë të shtetases E.M për shkak të racës nga ana e Qendrës Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan.
2. Në referim të pikës 1, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjë rikthimin e E.M në vendin e mëparshëm të punës.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Qendra Spitalore “Xhafer Kongoli” Elbasan, detyrohet që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**